

LETRAT E MIA KREDENCIALE

BESNIK MUSTAJ

në një rrëfim me

ARTA MARKUN

BOTIMET TOENA

Letrat e mia kredenciale

Besnik Mustafaj

në një rrëfim me

Arta Markun

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2018

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Anrila Spahija

Korrektore letrare dhe përkujdesja grafike: Arlinda Rrushi

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-18-3

© Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

PARAFJALË

*E vërteta është e çuditshme,
më e çuditshme sesa trillimi.*

XHORXH BAJRON

Atë mbrëmje binte shi, shumë shi. Çezare Pavese ishte i lumtur. Kish lënë takim me balerinën këngëtare të barit që mbushej dingas me studentë. Kish rënë përhumbtas në dashuri me të dhe, më në fund, kish marrë guximin ta ftonte për të pirë diçka. Takimin e kishin lënë në orën 18.00, përpara hyrjes së barit. Ai, natyrisht, kishte mbërritur më herët në takim. Mezi priste. Por, edhe nëse do të kish qenë i përpiktë në orar, do t'i kish takuar të priste. Gjatë, madje.

Shiu nuk kishte ndër mend të ndalte, kurse këngëtarja që i kish rrëmbyer zemrën nuk po dukej. Por ai priste, gjithsesi, s'ka gjë pse orët vraponin të zinin njëra-tjetrën. Kur u kthye më në fund në shtëpi, ishte natë e thellë. Qull nga shiu i rrëmbyer dhe i dërrmuar nga pritja e kotë, zuri shtratin, në ethe. Kish marrë plevitin. Iu desh edhe një herë të priste gjatë derisa ta linte sërish shtratin, i shëruar. Vetëm atëherë, disa muaj më pas, kur e ftohura kaloi dhe ai u rikthye në shkollë, mori vesh se kish pritur përpara hyrjes së gabuar të barit.

Tjetërkund e kish lënë takimin me balerinën e adhuruar.

Ishte viti 1925 dhe Çezare Paveze vetëm 17 vjeç. Sidoqoftë, thuhet se ai nuk kishte fat në dashuri.

Ndoshta kishte të drejtë Bajroni kur thoshte se *e vërteta është e çuditshme, më e çuditshme sesa trillimi*. A mos do të duhej të ishte e kundërta? E vërteta, realiteti, jeta, diçka krejt e zakonshme, si çdo gjë që përsëritet e përsëritet vazhdimisht në dritë të diellit, kurse trillimi, vepra, letërsia e jashtëzakonshme dhe befasuese si çdo gjë që del prej errësirës së laboratorëve të krijuesve? Me sa duket, jo. *E vërteta qenkësh e çuditshme*, duke i paraprirë edhe çudisë së trillimit. Dhe nuk duhet të jetë fjala vetëm për raste ekstreme sikurse është historia e Varlam Shalamovit, i cili, kur vendosi të hidhte në letër, nën titullin *Tregimet e Kolimës*, jetën e tij në gulagët e ish-Bashkimit Sovjetik, që i bindur se *realiteti i tij ishte më i fuqishëm se çdolloj trillimi*. Me gjasë, realiteti ia kalon trillimit, gjithnjë, vetëm se ne, ndoshta, s’e shohim dot, s’e vëmë re, s’e pikasim.

Cila është e vërteta, realiteti, jeta e një poeti? “Çudia” që e mbështjell? Misteri?

* * *

Gjithnjë e kam përfytyruar studion e shkrimtarit si një vend misterioz. Një vend të pushtuar nga zëra që vështirë t’i dëgjojnë të gjithë. Me hije që lëvizin pa u vënë re nga të tjerët. Një hapësirë në gjysmerrësirë, ku drita përqendrohet në një pikë: mbi fletën e bardhë, për të fokusuar vëmendjen e njeriut që shkruan. Me siguri një fjollë e hollë tymi nga

hirnorja ku është mbështetur cigarja, bën lakadredha drejt tavanit. Jashtë është natë, gjithmonë natë. Në përfytyrimin tim, shkrimtarët shkruajnë natën sepse ditën, fantazmat e studios (si të gjitha fantazmat) i tremb drita që hyn pashmangshëm prej dritares. Ama, nuk duhet të jetë një përfytyrim kryekëput pjellë e fantazisë sime. I ka nxitjet e veta reale. Te rrëfime shkrimtarësh, natyrisht.

Po ja, kam lexuar se Bukovski shkruante veç natën, i rrethuar nga re tymi duhani dhe avuj alkooli. Kështu thonë biografët e tij.

Pres mesnatën, më pat thënë mua vetë, dikur, një shkrimtar, si për të ma pohuar hamendësimin tim. Apo ndoshta më pat thënë se e priste më parë, në fillesat e tij e tash s'e pret më, se s'ka pse ta presë, apo nuk ka kohë ta presë, duke mbetur, gjithsesi, shkrimtar, pavarësisht kohës kur shkruan. Madje, më shumë shkruan ditën...

E megjithatë, përfytyrimi i studios së shkrimtarit nuk më cenohet nga rrëfimet e ndryshme, të kundërta shpeshherë, të shkrimtarëve të vërtetë. Në përfytyrimin tim, jashtë vazhdon të jetë natë. Në përfytyrimin tim, sikurse drita është themelore për procesin e fotosintezës prej nga varet jeta e bimës, ashtu errësira është themelore për procesin e krijimit prej nga varet jeta e një libri. Kurse ditën, edhe nëse grilat e dritares janë të puthitura, drita e gjen një plasë për të depërtuar bashkë me zërat dhe zhurmat që shpërqendrojnë shkrimtarin dhe trembin personazhet.

Një aromë e lehtë boje shkrimi më shpon flegrat dhe gërvima e stilografit mbi letër që mbush hapësirën, më përzihet me pëshpërimat e përfytyruara të fantazmave miqësore. E megjithatë, qetësi, shumë qetësi. Dhe një vetmi e thellë.

Aty-këtu them se ka shkrimtarë që e gjejnë atmosferën e studios së tyre në përshkrimin tim. Të tjerë janë larg këtij përfytyrimi. Dikush, një shkrimtar thellësisht bashkëkohor, mund të ketë një studio të lëvizshme, gjithçka në një laptop, futur në një çantë hedhur krahaqafë, që bëhet “bankë” shkrimi kudo e kurdo.

Kortazari pat shpjeguar në një intervistë, se në të ri të tij, shkruante pa shqetësimin më të vogël në mes të zhurmës së një kafeneje. Asgjëkund studio. Ose, lëvizëse edhe “studioja” e tij. Nuk e bezdiste zhurma. Përkundrazi, ishte një mbështjellje e parapëlqyer që e rrethonte si një kambanë qelqi e që e izolonte (çuditërisht) nga rrethepërqarku. As që i lipsej studioja, pra. Por gjërat ndryshuan me kohën, dhe qetësia absolute iu bë e domosdoshme. Deri edhe muzika në sfond nisi ta pengonte, sepse: *muzika është tjetër gjë, e të shkruarit tjetër*, thoshte ai.

Edhe një grerëz në xham e dëboj para se të ulem të shkruaj, - më erdhi ndër mend një mani, po e quaj kështu, tashmë e shkrimtarit shqiptar, Agron Tufës. Një copëz bisede e vjetër që m’u shfaq papritmas si për të më bindur për nevojën e vetmisë së shkrimtarit. Për nevojën për të qenë absolutisht brenda vetmisë së tij ku kanë të drejtë të hyjnë e të sillen, sado zhurmshëm, vetëm personazhet.

Qoftë përfytyrim i bazuar në fantazi, qoftë përzierje fantazish me fakte të mësuara aty-këtu, nga anë, kohë e vende të ndryshme, qoftë një fakt i pastër i papërzier me as më të voglin hamendësim, studioja e shkrimtarit mbetet *një e vërtetë që* “çudinë” e ka gjithnjë me vete, si një damkë të pashlyeshme.

Për vete i kam lexuar gjithnjë me kureshtje intervistat e shkrimtarëve, me gjasë, mes të tjerash, e joshur nga *e vërteta e çuditshme*. I kam intervistuar vetë, me të njëjtën kureshtje, gjithnjë, shkrimtarët. Askush nuk më foli ndonjëherë për ndonjë pritje të gjatë e të kotë nën shi, por *të vërteta të çuditshme*, sidoqoftë, më rrëfyer të gjithë.

Për shembull, Ervin Hatibi, këtu e 15 vjet të shkuara, më pat thënë se (çuditërisht) *kishte një lloj sikleti kur shkruante. Se mezi priste që një zile telefoni, apo shenjat e urisë, ta detyronin të çohet e ta braktiste letrën e bardhë.*

Për shembull, Mira Meksi më pat rrëfyer për *pasionin e pazakontë për kukullat që e rrethojnë në studion e saj.*

Për shembull, Helena Kadare më pat zbuluar ndarjen në grupe të ditëve të të shoqit: *ditët e përshtatshme për krijim, dhe të tjerat, për arsye nga më të ndryshmet, jo të përshtatshme. Nga çfarë përcaktohet ky dallim s'është aq e qartë. Ajo që kuptohet është vetëm se këto dy lloje ditësh nuk përzihen me njëra-tjetrën, - më pat thënë Helena.*

Për shembull, Ridvan Dibra më pat folur për *ankthin që e kaplon në 40- 50 faqet e para të romanit, kur ka ndjesinë e të qenit i humbur*. Si për paradoks ai i referohej Kafkës sipas të cilit: *“Shkrimtari që nuk shkruan sikur i bën ftesë çmendurisë, pra e thërret...”*. Të njëjtën gjë ndiente edhe vetë shkrimtari nga Shkodra: *të mosshkruarit, për të, është një gjendje parahatie e skajshme*. E po, gjendje “çmendurie” kur nuk shkruan e ndjesia e humbjes kur sapo nis e shkruan. Çfarë duhet të bëjë?!

Pra, të vërteta janë të gjitha rrëfimet, të çuditshme njëkohësisht.

Nëse vijoj me rrëfime shkrimtarësh me të cilët kam biseduar, nuk do të bëj tjetër veç *do të vërtetoj se të vërtetat janë me të vërtetë të çuditshme*. Pa asnjë dyshim, Bajroni kishte të drejtë...

* * *

Ndër shkrimtarët që kam intervistuar, mes të tjerëve, e ndoshta më shumë, është Besnik Mustafaj. Gjithnjë me kureshtjen e përmbushur dhe me bindjen për t'u rikthyer sërish për intervistën e radhës.

Dikur, në një takim të një kohe disi të largët prej këndej, pata ndër (çuditërisht), në ajër, erën e athët të bojës së shkrimit. Më ishte shfaqur Orhan Pamuku (ky detaj i ngulitur në kujtesë më bën të mendoj se takimi paskësh qenë diçka më shumë se 10 vjet të shkuara, kur Pamuku sapo kish fituar *Nobelin*). Ai thoshte se *shkruante ngase i pëlqente era e letrës* (e çuditshme aq sa e vërtetë). E në logjikën e nobelistit turk, edhe era e bojës ka diçka joshëse që nxit shkrimin.

Natyrisht, përshtypja ime e aromës së bojës në ajër, në rastin konkret të takimit me Mustafajn, e kish pasur një bazë reale. Mbi tryezën e rrumbullakët të barit ku qemë ulur, në një hapësirë jo dhe aq të hapësirshme për shkak të pallateve të larta që e rrethonin barin, shkrimtari pati nxjerrë një fletore relativisht të trashë me një format relativisht të vogël. Stilografit, shtrirë mbi të, ia kish hequr kapakun që ishte rrotulluar mbi sipërfaqen e lëmuar të tryezës, për të ndalur pranë një togu rezervash boje.

I çuditshëm edhe fakti sesi kujtimet ndjellin kujtime. Ja tani tek m'u përvijua çasti kur mora vesh se *Montblanc* prodhonte edicione të limituara stilografësh që përfaqësonin shkrimtarë të ndryshëm. Kur i pata zbuluar, e mahnitur pata ndalur gjatë para fotos që paraqiste stilografin *Honoré de Balzac*. Forma evokonte staturën e pangatërrueshme të shkrimtarit, disi e fryrë në mes, si dhe mënyrën e tij të veshjes pa shpërfillur as bastunin me lulet e bruzta. Mbi shpinën e penës, të gdhendura me ar, inicialet. Kushtonte 705 euro. Stilografë të tjerë përfaqësonin Franc Kafkën, Karlo Kolodin, Tomas Manin, Servantesin... E pata lënë veten të hutohesha mbi fotot e tyre me mendimin që të zgjidhja stilografin e preferuar. Në aspektin vizual më dukej se shijeve të mia, ndoshta, u përshtatej stilografi *Kafka*, por, me gjasë, për solidaritet femëror, do të kisha zgjedhur Virxhinia Vulfën, për nostalgji do kisha parapëlqyer Karlo Kolodin, tim eti do t'i kisha dhuruar Zhyl Vernin... Cilin syresh do të kishte zgjedhur Besnik Mustafaj? Ndoshta Balzakun, për shkak të Francës, si një pikë përkimi?

Nuk mund ta them se me ç'stilograf kish qenë duke shkruar Besnik Mustafaj, teksa unë gjendesha në rrugë e sipër për në takimin e dikurshëm. Nuk kisha asnjë dijeni asokohe për stilografët e shkrimtarëve *Montblanc*. Ende s'e kisha mësuar lidhjen e Mustafajt me stilografin si mjet i domosdoshëm shkrimi. Aq më pak e dija se ai kishte një koleksion të tërë stilografësh.

Ndaj, njëfarësoj, e shpërfilla mjetin e shkrimit.

Sakaq, gjithë me aromën e bojës në flegra, i pata vënë mend fletoret. Gjysma e saj mbushur me fjalë të shkruara me blu. Ama, vetëm faqet e parme. Të pasmet bosh. Tek-tuk, ndonjë

shigjetë, siç më shpjegoi shkrimtari, nënkuptonte ndonjë ndryshim të bërë më vonë. Ndryshimet shënohen në faqen e pasme, të cilën Besnik Mustafaj, me këtë qëllim e lë bosh: nëse do të ndryshojë diçka, apo edhe të përmbysë, ja ku është vendi. Megjithatë, siç më tha, pothuaj nuk e bën ose rrallëherë e bën. Ngase shkruan ngadalë, shumë ngadalë e kur lë gjurmën mbi letër është menduar mirë. I jep vetes aq shumë kohë për t'u menduar, sa njaftohet duke shkruar vetëm një faqe në ditë. Ndaj dhe faqet e pasme janë pothuaj të bardha, por jo krejt...

Përveç fletores, tani e di se sa të domosdoshëm janë për Mustafajn stilografët. Vetëm stilografët, për të shkruar. Me bojë, pra, e cila ka rëndësi që të jetë gjithnjë me të njëjtën ngjyrë. Doemos, vetëm blu, sikurse maja e stilografit doemos vetëm me njëfarë trashësie në mënyrë që gjurma mbi letër (çuditërisht, sepse nuk është aspak hamendësim) të ketë plotësinë e vet.

Këto mani të vogla i ka konsoliduar viteve, në vend që t'i përshtatej kohës. Përfundimisht, nuk mund të shkruajë në një tjetër mënyrë, sado që kompjuteri rri aty, mënjanë tryezës duke ofruar tastierën e vet aspak të zhurmshme krahasimisht me atë të makinës *Olivetti* që i paraprinte në shtëpinë e shkrimtarit. Valët e internetit mbërrijnë deri atje, gati për të të sjellë gjithë botën në një dhomë, por shkrimtari e përdor veç kur s'ka asnjë mundësi ta shmangë... A nuk ka një kontradiktë këtu, një lloj të vërtete të çuditshme? Mu në mes të botës moderne, burri me sjellje arkaike.

A nuk është e çuditshme, aq sa edhe e vërtetë pamja e studios me kompjuter dhe internet që shpërfillen, megjithatë,

në favor të fletoreve me vija tipike shkollarësh, që mbushen me shkrim dore, njëra pas tjetrës, ngadalë, ndriçuar nga llamba e verdhë e abazhurit që e lë në gjysmerrësirë pjesën tjetër të dhomës?

Kontradikta, nëse pranuar ta quajmë kështu, është zgjatim i ballafaqimit të imazhit të burrit me syze të modës së fundit, përsosmërisht rrethore e skelet të hollë metalik, *në përshtatje me relievin e ndryshuar të fytyrës ndër vite*¹, me gishtat e zverdhur nga duhani që dredhin mjeshtërisht një cigare, ngjashëm me tropojanët e dikurshëm të odave të burrave që i kanë shënjuar fëmijërinë, këtu e gjysmë shekulli më parë...

Në atë takim të largët me Besnik Mustafajn, që më përvijohet gjithnjë bashkë me erën e bojës së shkrimit, pata mësuar se fletoren me vija, atëherë, e mbante gjithnjë me vete, në një çantë të vogël prej lëkure të zezë, të cilën nuk e harronte kurrë, as në makinë. Me gjasë, shkaku kryesor i këtij përkujdesi ishte kutia e duhanit të dredhur që nuk ia ndan vetes, si një ves (apo kënaqësi e vogël e jetës) nga i cili nuk do të heqë dorë. Sa ulej në një tryezë bari, e para gjë që nxirrte nga çanta ishte duhani, merret me mend. Fletoren, sipas rastit. E megjithatë, ajo duhej të ishte aty, doemos, në çantë. Sepse mund të ndodhte që shkrimtari të mos ishte i disiplinuar asaj dite, mund të mos kthehej dot në kohën e duhur në studio, dhe puna nuk priste. Pastaj, darkat mes miqsh dhe një gotë verë e mirë kishin diçka magnetike. E

¹ *Kam një plagë në përfytyrim, Biri i Adamit*, B. Mustafaj.

kanë ende, por tani gjithçka e përcaktojnë prioritetet. Nuk ka më kohë për të humbur.

E kuptova në takimet e mëvonshme që, me gjithë kënaqësinë e një gote verë të mirë me miq, brenga për kohën e humbur, vjedhur letërsisë, vinte duke u mprehur. Kështu që kthimi sa më shpejt në studio bëhej, gjithnjë e më shumë, domosdoshmëri. E pashmangshme. Pra, fletorja rri mbi tryezë, tashmë. (Në çantën e vogël prej lëkure të zezë, sigurisht që ka gjithnjë diçka ku mund të shkruhet.) Prej disa kohësh, ngjashëm me Kortazarin, që dikur hoqi dorë nga kafeneja e zhurmshme për t'u mbyllur në qetësinë e studios, edhe Mustafaj e ka “burgosur” veten në vendin e letërsisë: studioja e tij, në shtëpinë e ndërtuar enkas për të përmbushur shijet e veta, disa kilometra larg e lart Tiranës, faqes së Dajtit që sheh qytetin, rrethuar vetëm nga zhurmat e natyrës. Por, ndryshimi thelbësor është organizimi i kohës, pothuaj ekskluzive për letërsinë. (Ndoshta asgjë e çuditshme në faktin që koha rrjedh duke lënë pas ndryshime të llojllojshme.)

E megjithatë, era e bojës së shkrimit dhe gërvima e majës së stilografit mbi letër, mbeti shoqëruesja e pandryshueshme pa të cilën Besnik Mustafaj nuk bën dot (çuditërisht).

* * *

Pa dyshim, *të vërtetat e çuditshme* të shkrimtarit nuk fillojnë e mbarojnë këtu, në një mjedis pune, pavarësisht tekave dhe manive që e bëjnë të ndryshëm mjedisin nga shkrimtari në shkrimtar.

Nëse studioja e shkrimtarit është një vend misterioz, aq më tepër është i tillë procesi që zhvillohet aty. Për më tepër, te procesi e ka zanafillën çdo gjë. Sepse, me të dalë shkrimtari nga studioja, ajo bëhet një hapësirë si çdo hapësirë tjetër... Vetëm prania e tij, gjatë procesit, për më tepër, i bën gjërat kryekëput të çuditshme.

“A mund ta pyesësh një muzikant xhazi se çfarë do të luajë? Kishte për të të qeshur në fytyrë”. Për Kortazarin, të shkruarit është si improvizimi në xhaz... Kjo është *e vërteta e trillimit*, ose njëra syresh, që është *më e çuditshme se trillimi vetë*.

Kishte të drejtë Bajroni...

Në fillim një ide i përsillet mjegullt në kokë shkrimtarit. Pastaj ca nga ca konturet nisin e i qartësohen. Është momenti kur ai s'mundet veç të ulet e ta hedhë në letër. Se kur vjen ai moment, nuk dihet... Nuk e di as vetë shkrimtari. Ai veç bindet teksa diçka ndien. Në pjesën që vjen më pas, ai zbulon se është një kureshtar që i pëlqen të marrë vesh se ç'do të ndodhë, i çuditur edhe vetë, pasi ajo ndodh. Po flas për shkrimtarët në përgjithësi, por po flas edhe për Besnik Mustafajn në veçanti.

- *Unë i besoj asaj anekdotës që tregohet për Tolstoin*, - m'u kujtua sërish biseda e vjetër me Mustafajn në barin me tryezën e vogël, rrethore, plastike.

Dhe pati filluar të më tregonte se si Tolstoi pati lënë penën mbi letër e pati dalë në oborr duke qarë.

- *Ç'ke shkëlqesi, ç'ka ndodhur? - i thotë kopshtari.*
- *Vdiq Ana Karenina, u hodh në rrotat e trenit.*
- *Po kush ishte kjo, shkëlqesi? - i thotë sërish kopshtari.*
- *Ishte personazhi i romanit tim.*
- *Por ju mund ta shpëtonit, shkëlqesi.*
- *Jo, - përgjigjet Tolstoi, - ajo, atë fat kishte.*

Mund të ketë ndodhur vërtet. Por mund të jetë një legjendë nga ato që i vishen gjithnjë emrave të mëdhenj e që pasqyrojnë, sidoqoftë, realitetin e Tolstois. Të vërtetën e tij, që ishte e çuditshme edhe për atë vetë. Pra, shkrimtari nuk mundej t'i hynte ndonjë shpjegimi qartësues për të fashitur çudinë e kopshtarit. Nganjëherë më shkon mendja se s'duhet të ketë dashur. Se, të themi të vërtetën, shkrimtarit i pëlqen misteri, apo çudia që e mbështjell. Është interesante, intriguese për të tjerët rreth e rrotull. Dhe le të mbetet kështu, qoftë edhe deri diku. Por në fund prirem të pranoj se vërtet nuk ka mundur. Ndaj mbeti e çuditshme për kopshtarin zgjedhja e Ana Kareninës. Jo vetëm për kopshtarin, për më tepër.

Pasi e kam pranuar misterin që mbështjell procesin, më vjen të besoj se kjo historizë, që ka për protagonistë një shkrimtar të vërtetë e të madh dhe një personazh letërsie tejet të njohur, është trillim i një tjetër shkrimtari që nuk ia dimë emrin. Dikush që më shumë se të vërtetën e çuditshme të Tolstois, ka dashur të shprehë të vërtetën e vet, gjithaq të çuditshme, një e vërtetë universale shkrimtarësh, njëkohësisht. Nëse ka

përrjashtime, si gjithnjë, ato s'bëjnë tjetër veç përforcojnë rregullat.

Kështu duhet të jenë shkrimtarët, pra...

Por, ndërsa zgjedhjet e personazheve, apo shumëçka lidhur me procesin, shkrimtari herë nuk do e herë nuk di t'i shpjegojë, disa prej të vërtetave vetjake ai i nxjerr në dritë të diellit, ose ia nxjerrin të tjerët.

Atëherë, kush janë shkrimtarët dhe *të vërtetat e tyre të çuditshme*? Përse janë të tillë? Përse shkruajnë? Si shkruajnë ata? Ç'e nxit ngjizjen e një krijese? Si e shohin shkrimtarët krijesën e tyre në raport me krijesën e krijuesit të madh? A besojnë te krijuesi i madh, te Zoti? Ç'mendojnë për dashurinë, urrejtjen, jetën, vdekjen, misterin?

Mandej, si i shohin ata gjërat konkrete dhe të prekshme të jetës? Ç'është për shkrimtarët politika apo politikani? Po ata vetë, pse ndodh ndonjëherë të jenë politikanë dhe shkrimtarë njëkohësisht? A janë të majta apo të djathta bindjet e tyre?

Ç'mendojnë për njëri-tjetrin? Për çmimet që i kanë marrë e nuk i kanë marrë? Xhelozë? Rivalë? Modestë? Narcisë? Mosbesues? Të vetëdijsëm?

A u tremben lexuesve? A e ndiejnë praninë e tyre teksa shkruajnë? Po për kritikët, çfarë mendimi kanë?

Cilat janë rrugët nëpër të cilat kanë ecur qysh nga fëmijëria shkrimtarët? A kanë qenë rrugë të sheshta apo përplot pengesa? A kanë mundur t'i parashikojnë pengesat, apo i kanë zbuluar papritmas kur s'kishin as më të voglën mundësi për t'i shmangur? Po udhëkryqeve si janë ndier, si kanë vepruar?

Pasiguri? Frikë? Makth? Apo entuziazëm për mundësitë e reja që hamendësohet se ofrojnë udhëkryqet?

A i gjykojnë ata të çuditshme të vërtetat e tyre? A janë në një mendje me Bajronin, kur thotë se e vërteta është e çuditshme, më e çuditshme sesa trillimi?

Lexuesit me të drejtë bëhen kureshtarë. Kurse shkrimtarët, mirëkuptues (fundja janë edhe ata vetë lexues), diçka bëjnë për t'ua përmbushur kureshtjen. Japin intervista, u përgjigjen pyetjeve.

* * *

Do ta intervistojta Besnik Mustafajn, kësaj here, me një këmbëngulje të ndryshme nga të gjitha herët e tjera. Me këmbënguljen e dikujt që kërkon të vështrojë në një kënd të gjerë shikimi. Krejt të gjerë, 360 gradë. Iu vura punës për të zbuluar gjëra që vështirë të zbulohen faqeve të prozës apo vargjeve të poezisë. Sigurisht, letërsia bën zbulimet e veta, por zbulimet, këtyre rasteve, shpesh lidhen me lexuesin më shumë sesa me autorin. Që do të thotë se zbulimet e lexuesit, teksa mund të jenë të ndryshme nga lexuesi në lexues, mund të mos përkojnë asfare me ato të autorit. (Ndaj janë intervistat?)

Në këtë bashkëbisedim të gjatë, kur herë ndalnim në një libër, në një personazh, në një varg, herë në një informacion të marrë kushedi se ku, në një kujtim, në një copëz bisede të vjetër, herë në një kohë më të largët e herë në një të djeshme fare të afërt, herë në një qytet joshës si Parisi e herë në një vend mistik si Shkëlzeni apo oborri i shtëpisë së fëmijërisë pushtuar nga zhurma të pashpjegueshme, sidomos natën...

pandërprerë më ndiqte silueta avullore e përfytyruar e shkrimtarit, në tavolinën e punës prej druri të errët, rrethuar nga biblioteka, ku ulet çdo mëngjes sapo alarmi lajmëron mbërritjen e orës tetë.

Jashtë nuk është errët, por ende qetësi. Nuk është aspak natë e thellë si në përfytyrimin tim të përgjithshëm. (Se Mustafaj më ka ndezur tashmë disa drita, për të parë më qartë.) Veç në mos, njëfarësoj, në dimër, sidomos ditëve të vrenjtura a me shi, kur është, gjithsesi, gjysmëdritë e gjysmerrësirë, apo më pak dritë e më shumë errësirë. Në këtë rast, ndoshta, duhet filluar me ndezjen e oxhakut. Dhe sa mirë për të tjerët, kur të zgjohen më vonë, ngrohtësia e zjarrit do të ketë filluar të përhapet nëpër shtëpi. Në verë është vetë flladi i malit nxitës për zgjimin. Por dimër a verë qoftë, pranverë a vjeshtë, asgjë s'ë ndryshon thelbin. Natyra me format dhe ngjyrat e saj të ndryshueshme apo intensitetin e luhatshëm të dritës, mbetet jashtë xhamave të dritares.

Pavarësisht stinës, mbi skrivani stilografët janë gati. Asnjë shishe me bojë aty rrotull. (Të ketë ruajtur shkrimtari ndonjë stilograf të vjetër me pompë, nga ata që mbusheshin në shishe kur zbrazeshin nga të shkruarit? Në njëfarë mënyre e kam pyetur për lidhjen me objektet, të vjetrat, sidomos emocionale, por jo për ndonjë prirje të mundshme antropologësh për të cilët thuajse çdo objekt është subjekt.) Stilografët, që presin për t'u gjallëruar nga apatia e natës, janë me rezerva të gatshme, mjaft të heqësh të boshatisurën dhe të vësh një të re. Vlerë ka thjesht stilografi, pena dhe era e bojës së shkrimit.

E përfytyrova shkrimtarin duke bërë, ngathët (i ka shumë të ngadalshme lëvizjet tek dredh, sado përsosmërisht, një

cigare e me siguri të tilla duhet t'i ketë edhe kur ndërron rezervën e një stilografi) veprimet rutinore të fillimit të punës dhe pastaj të zhytur mbi fletore deri rreth orës 11.00. Në këtë ndërkohë hapësira është e pushtuar nga zërat që vetëm ai i dëgjon, s'ka gjë se nga përtej dritares depërtojnë cicërimat. Nga ana tjetër e shtëpisë, mbërrin aroma e kafesë turke që Dona e përgatit në xhezve dyshe pa sheqer.

Drita e ditës nuk qenkësh pengesë për shkrimtarin. Në studio nuk hyhet vetëm natën. Sidomos kur je shkrimtar me kohë të plotë, si Besnik Mustafaj.

* * *

Më duket se deri tani fola vetëm për shkrimtarin. Por kjo s'do të thotë se kam intervistuar vetëm shkrimtarin. I kam intervistuar të gjithë: veç shkrimtarit, diplomatit me dyshimet, pasiguritë dhe pengjet; politikanin që tërheq skajin e kundërt të të njëjtit litar tërhequr edhe prej shkrimtarit; deputetin që kur e pa veten në parlament nuk kish lexuar kurrë një ligj; gazetarin që e brodhi Shqipërinë cep më cep; pedagogun që s'e kishte hiç përzemër mësimdhënien; intelektualin, për të cilin zgjerimi i horizontit është domosdoshmëri; qytetarin që nuk mund të rrijë shpërfillës ndaj terrenit mbi të cilin vë këmbët; burrin që gratë i mishëron në poezi; bashkëshortin, të cilit i duket e zbrazët *Shtëpia pa Donën*²; babain që ngjan dhe nuk ngjan me babanë e vet; birin që, sidoqoftë, nuk e vrau kurrë atin; nipin që ruan kujtimin e mrekullueshëm të

²Titull poezie, *Harrimi i dashurisë*, B. Mustafaj.

gjyshit dhe dy grave të tij... Kam intervistuar burrin e sotëm, djaloshin që rritet, adoleshentin që i largohet qytetit të lindjes, fëmijën që nuk i pëlqen të luajë futboll...

... Kur Çezare Paveze priste me këmbëngulje nën litarët e shiut të vluarën që nuk mbërriti kurrë, ishte gjimnazist. Gjimnazist edhe Besnik Mustafaj, kur e ndoqi pas të vluarën e zemrës, për t'i dhënë poezinë që kish shkruar për të... E kam intervistuar edhe gjimnazistin, pa dyshim. Me shumë kënaqësi dhe kureshtje, të gjithë këta njerëz, brenda të njëjtit njeri.

* * *

Për vete, në fakt, pak nga përfytyrimi, pak nga pyetjet që më dalin gjithnjë gjatë leximit e pak nga rrëfimet vetjake, i kam lexuar gjithnjë me dëshirë intervistat e dhëna nga shkrimtarët. E me të njëjtën dëshirë, unë i kam intervistuar ata, gjithnjë. Pothuaj kurrë zhgënjyer nga rrëfimet, nga *të vërtetat e çuditshme* që më kanë zbuluar. Po kështu, kësaj here, edhe me Besnik Mustafajn, përgjatë këtij rrëfimi të hollësishëm, teksa vazhdimisht më fanitej aty-këtu Bajroni duke pohuar se *e vërteta është e çuditshme, më e çuditshme sesa trillimi*.

Shpresoj që ju, të dashur lexues, të nxiteni nga e njëjta kureshtje dhe të ndieni të njëjtën shije në këtë zbulim, që është edhe i juaji, të Besnik Mustafajt dhe të *vërtetave të tij të çuditshme*, që nis me një vizatim burri për fëmijën e dikurshëm dhe ndalet te fotografia e të sotmes kur *fëmijën brenda burrit e ka zbehur shkurtimi i kohës që i është dhënë për të jetuar...*

Shpresoj, ta shijoni, pra, letrën e tij më të gjatë *kredenciale*.

1

*ARTA MARKU: - “Vogëlush, më pyet ç’është **dashuria**? Rritu që ta marrësh vesh. Vogëlush, më pyet ç’është **lumturia**? Rri fëmijë që ta ndiesh” ... Dua ta fillojmë me këto vargje të Xhim Morrisonit për shumë arsye... mbi të gjitha për faktin se, në përgjithësi, besojmë se fëmijëria dhe lumturia janë një dyshe e pashqitshme... Ç’e bënte të lumtur fëmijërinë tuaj?*

BESNIK MUSTAJ: - Xhim Morrisoni është një nga këngëtarët e mi më të dashur. Do të thosha, megjithatë, se në këtë rast ai nuk e shpreh të vërtetën time. Fëmijë nuk kam qenë kurrë i prekur nga sindroma e Piter Panit. Madje, kam pasur njëfarë padurimi të pazakonshëm për t’u rritur. Dhe as i rritur, as tani që kam hyrë në njëfarë moshe, nuk e çoj mendjen te fëmijëria si te lumturia *genuine* e humbur në pakthim. Kjo ndoshta ngaqë, në përgjithësi, nuk jam fare nostalgjik, siç nuk kam qenë dhe aq më pak jam tani, ëndërrimtar i madh për të ardhmen. Marrëdhëniet intensive i kam pasur gjithmonë

dhe vazhdoj t'i kem me të sotmen. E tanishmja është për mua koha më e bukur dhe përpiqem ta jetoj fort, kuptohet, sipas mënyrës sime.

Unë as nuk e kundërshtoj dhe as nuk e miratoj përcaktimin tuaj se fëmijëria dhe lumturia është një dyshe e pashqitshme. Thjesht nuk më kujtohet të kem menduar ndonjëherë në atë moshë për lumturinë as si prani dhe as si mungesë. Por, nëse rendis tani përmbledhtazi elementet që e bëjnë lumturinë e një fëmije, do të thosha pa ngurrim se kam qenë i lumtur. Isha djali i një nëpunësi lokal të paguar mirë. Babai im ishte në fillim shef llogarie në një ndërmarrje, pastaj drejtor i bankës. Pra, ushqehesha dhe vishesha më mirë se shumica e moshatarëve të mi. Më plotësoheshin pa shumë lutje dëshirat për argëtim, për faktin se përputheshin më së shumti me dëshirat që kishin prindërit e mi për mua. Nuk jam dhunuar kurrë. Gjatë gjithë fëmijërisë mbaj mend vetëm një shpullë nga babai. Nëna, edhe sepse ishte më e pranishme se babai në përditshmërinë e familjes, edhe sepse në karakter ishte më e rreptë, tregohej shpesh kërcënuese, qëllonte edhe të më shkulte pak veshin, por asgjë më shumë. Kurrsesi e dhunshme. Në familje, ku jetonim gjyshi, gruaja e parë e gjyshit, e cila nuk kishte pasur fëmijë, gjyshja ime, prindërit dhe dy vëllezërit e mi më të vegjël, nuk kam parë kurën e kurës sherre. Shkurt fjala, nuk jam rritur aspak me ndjenjën e frikës, të ndrydhjes. Dhe nuk ruaj përshtypjen se në fëmijëri më janë bërë padrejtësi. Çfarë i duhet më shumë se kaq një fëmije për të qenë i lumtur?

- *“Ta pretendojë atë që dëshiron”, thotë dikush se është një karakteristikë e fëmijës. Ta marrë atë që dëshiron, besoj unë, është përmbushja e lumturisë së tij. Ndaj them se nuk i lipset me shumë një fëmije se **plotësimi i dëshirave**. Megjithatë, si e gjykoni: në favor të burrit të ardhshëm, vlen më shumë **lumturia e fëmijës**, apo duke qenë e trazuar, fëmijëria ka mundësinë të shndërrohet në një përvojë më të vlefshme?*

- Të them të drejtën, unë nuk i besoj teorisë se një fëmijëri e trazuar e pajis shkrimtarin e ardhshëm me një përvojë më të çmuar se një fëmijëri e lulëzuar. Kjo teori buron më shumë nga biografët, do të kisha thënë unë, të cilët kanë dashur ta bëjnë jetën e shkrimtarëve të mëdhenj po aq interesante e të veçantë sa vepra e tyre, mundësisht t'i bënin viktimë në periudhën e rritjes si njerëz, duke gjetur kështu shpjegimin pse ata kanë synuar thelbësisht të japin dramën e njeriut, duke zbuluar anën e errët të botës së tij. *Më jepni një dhimbje, t'ju jap një kryevepër*, përmendet të ketë thënë Dostojevski. Ne nuk e njohim fëmijërinë e Shekspirit, por nuk ma merr mendja se ndonjë përvojë nga fëmijëria e vet e ka çuar drejt shkrimit të *“Mbretit Lir”*. Për më tepër, jam i bindur se një fëmijëri e trazuar, e ndrydhur, lë zakonisht një ndjesi padrejtësie të pashlyeshme në kujtesën e burrit të ardhshëm, i cili rrezikon gjithë jetën të torturohet nga një shtysë e fshehtë për revansh. Një shtysë e tillë më duket e dëmshme për shkrimtarin, i cili në punën e tij duhet të jetë shumë i drejtë me personazhet e veta, do të thosha edhe më i drejtë nga ç'është një gjyqtar në sallën e gjyqit. Përndryshe, ai do të krijojë një realitet letrar të çekuilibruar.

Por as kjo që po them unë nuk mund të përbëjë një teori për të rrëzuar të parën. Unë thjesht mendoj se teori të tilla nuk mund të merren si teorema. Ajo çka shkrimtari i ardhshëm mbart nga fëmijëria janë disa shqisa dhe reflekse që ushqejnë imagjinatën, të cilat lindin dhe zhvillohen në atë periudhë të hershme të jetës së tij në mënyrë krejtësisht misterioze, sepse nuk zhvillohen në përputhje me ndonjë ambicie të vetëdijshme nga ana e fëmijës. Për mua këto shqisa dhe reflekse të krijuara gjatë fëmijërisë veprojnë vetvetiu, në mënyrë të vlefshme për shkrimtarin e ardhshëm, ashtu si loja me top lecke në tokën e fortë e me pluhur të lagjes me kalamajtë e moshës së tij përbënte stërvitjen zanafillore për Pelen, i cili ishte nisur, pa e ditur, për t'u bërë futbollisti më i mirë i botës.

- Ndjesitë, përshtypjet e fëmijërisë nguliten thellë në zemër si tatuazhe të pashlyeshme. Kur duken sikur janë fshirë, në fakt vetëm sa janë mbuluar. Mund të rinisin të jetojnë pa pasur nevojë për arsye dhe shpjegime. Cili është imazhi themelor (ndjesia, përshtypja), i pashlyeshëm, që konfigurohet nga tatuazhet e fëmijërisë suaj?

- Do të thosha gjyshi, i cili kishte një mënyrë autentike, një enigmë për mua kjo edhe sot e kësaj dite, për të më bërë të ndihem i rëndësishëm qysh në moshë të hershme, ndoshta tetë a nëntë vjeç. Nuk ishte një plak që merrte pozën e patriarkut duke dhënë këshilla apo qortime për pasardhësit e vet. Të paktën unë nuk e mbaj mend duke më dhënë këshilla

të drejtpërdrejta. Por as fizikisht nuk ngjante me malësorët e moshës së tij. Ishte një burrë i imët, shtatvogël, me një grimë mustaqe nën hundë, që nuk iu thinjën plotësisht deri në fund dhe që nuk mbajti kurrë kapelë, edhe pse flokët i kishin rënë me kohë deri në majë të kokës. Ndonjëherë, shumë rrallë, vinte qeleshe. Nuk e di çfarë kriteri kishte për të zgjedhur rastet kur duhej të shfaqej me qeleshe. Sidoqoftë, qeleshja ishte e vetmja shenjë e veshjes tradicionale të krahinës në paraqitjen e tij. Nuk e kam parë kurrë, as edhe një herë, të mbajë tirq apo xhamadan.

Gjyshi kishte arsyet e veta për të treguar një vëmendje të posaçme ndaj meje. Ai ishte i vetëm, pa vëlla, pa xhaxha, pa kushërinj të parë. Nga martesë e parë nuk kishte pasur fëmijë. Nga e dyta, me gjyshen time, kishte vetëm një djalë (babai im) dhe një vajzë. Parë në kontekstin e mentalitetit të kohës dhe të vendit, kjo gjendje fillikat i ngjallte, me siguri, ankth të vërtetë lidhur me vazhdimësinë e pemës së gjakut. Lindja ime, domethënë e nipit, i çeli horizontin. Ardhja e dy vëllezërve të mi më pas e qetësoi, e çliroi përfundimisht nga ankthi. Por ai vazhdoi ta mbante vëmendjen në një mënyrë të veçantë të përqendruar tek unë. Bie fjala, ishte këmbëngulja e tij që unë të vija në Tiranë për të vazhduar shkollën e mesme sa mbarova klasën e tetë. Nxënësit e mirë, siç isha unë, zakonisht, vazhdonin gjimnazin në Bajram Curr, ku kishte mësues shumë të mirë, për të ardhur më pas në Tiranë, në universitet, nga do të dilnin inxhinierë, mjekë, arkitektë. Për të kryer shkollën e mesme jashtë vendlindjes, zakonisht largoheshin ata që do të merrnin zanate, si teknik ndërtimi, teknik miniere, mekanik, pastičier. Unë, vërtet po

shkoja në shkollën e gjuhëve të huaja, një shkollë e zgjedhur kjo, por në fjalë të fundit, duke qenë nga Tropoja, pa asnjë lidhje farefisnore me pushtetin qendror, do të dilja thjesht mësues fshati. Gjyshi nguli këmbë: *Në kryeqytet dhe larg nesh, ku do t'i duhet t'i marrë vetë vendimet për jetën e tij të përditshme, djali piqet më shpejt dhe më mirë*, tha ai. Për të kishte rëndësi që unë të piqesha si burrë, të mësohesha të merrja vendimet që më përkisnin dhe jo aq profesioni, për të cilin do të diplomohesha. Ai nuk kishte fare dyshim se unë, adoleshent, krejt jashtë kontrollit të prindërve, të cilët do t'i shihja vetëm dy herë në vit, për festat e Vitit të Ri dhe për pushimet e verës, mund të shturesha. Kishte një besim instinktiv tek unë.

- *Unë isha i vogël, heronjtë shumë të mëdhenj,
Shumë më të lartë se trupat e statujave të tyre.
Duke u rritur,
Gjithnjë e më pak,
I shihja
Nga poshtë.
Sa erdhi mosha e u pamë në sy...*

*Kështu thoni ju në poezinë “Unë dhe heronjtë”. Kurse unë, diku kam lexuar se **kur një fëmijë kupton papërsosmërinë e të rriturve, bëhet adoleshent. Kur një adoleshent arrin ta falë papërsosmërinë, rritet...** Dhe rritja nënkupton momentin kur ju **shiheni sy më sy me heronjtë tuaj**. Cilat ishin papërsosmëritë e botës (heronjve) që ju futën në adoleshencë? Si do ta përshkruani procesin e faljes që ju rriti?*

- Ju keni leximin tuaj për këtë poezi, unë kam timin. Mendoj se kjo është një nga poezitë më të rëndësishme që kam shkruar. E kam shkruar në fillim të viteve '80 të shekullit të kaluar, kur isha 25 vjeç. Sipas meje, kjo poezi pasqyron procesin tronditës të çmitizimit të realitetit shoqëror e politik, brenda të cilit kisha lindur, isha rritur dhe po jetoja, çmitizim që po ndodhte fshehurazi brenda meje. Ishte diçka e ngjashme me thyerjen e pasqyrës gënjeshtare. Në mbyllje të poezisë, pasi thotë: "*Erdhi moshë, në u pamë sy më sy*" (me heronjtë), poeti pyet: "*Ç'do të ndodhë tani?/ Unë apo heronjtë do e kuptojmë/ Kush nga ne është i tepërti?*". Pra, ka ndodhur zhvendosja proporcionale, përmbysja do të thosha, e vendit që do të zërë njeriu dhe idhujt në hapësirën jetike të poetit. Është një poezi ikonoklaste, për të cilën më vonë jam çuditur si arriti të botohej. Edhe pse unë në atë kohë nuk isha ende plotësisht i vetëdijshëm, kjo poezi më duket se paralajmëron që në vazhdim, në jetën time, se asgjë nuk do të ishte më si më parë. Që do të thoshte se brenda kokës sime po ngjizej kuptimi për lirinë e vërtetë. Thënë më saktë, unë po arrija të konstatoja për mungesën e kësaj lirie. Rrjedhimisht do ta kërkoja atë. Përfundimi ishte i paparashikueshëm.

Për t'u kthyer te pyetja juaj, besoj se papërsosmëria më tronditëse që njeriu zbulon në këtë kapërcyell delikat të moshës nga fëmijëria në adoleshencë është se *jo të gjithë të mëdhenjtë të duan*. Shumë fëmijë pësojnë trauma të rënda nga një zbulim i tillë dhe fillojnë të kulpabilizojnë veten. Nuk ka qenë rasti im. Ky zbulim ka ardhur tek unë me një kontekst, do të thosha, justifikues. Siç ju tregova, unë

u largova sa mbarova klasën e tetë nga familja dhe qyteti im i lindjes, ku rrethohesha vërtet nga një dashuri shumë e madhe, e pakufishme dhe pa kushte. U vendosa në konvikt, në Tiranë, ku gjithçka ishte e panjohur, madje e huaj: regjimi ditor, shokët e shkollës, kujdestarët. Askush nuk ia kishte ngenë për t'i dhënë një përkëdhelje egos sime të lënduar, qoftë edhe me të drejtë. U detyrova menjëherë të bëja punët, për të cilat nëna ime nuk më kishte përgatitur aspak, si për shembull, të laja ndërresat e mia, të hekurosja këmishët e pantallonat, të fshija e të laja dhomën e përbashkët me nëntë nxënës të tjerë, kur kisha radhën. I njëjti mjedis ishte edhe në shkollë, ku mësuesit, me ndonjë përjashtim, nuk tregonin dhembshuri të madhe për ne, konviktorët. Nuk kam vënë re ndonjë prirje të mësuesve për të pasur në sjelljen e tyre shenja prindërore. Mendoj se në ato rrethana, tek unë janë zgjuar dy instinkte shpëtimtare: ai *i përshatjes* për të mbijetuar dhe instinkti *i ambicies* për të mos dështuar në shkollë. Ka pasur moshatarë të mitë, që e kishin në atë moshë më të zhvilluar se unë aftësinë e analizës, të cilët ranë në dëshpërim të thellë dhe u kthyen në familje nëpër rrethe, pa mundur kurrë ta rimarrin veten plotësisht. Ka pasur, madje, edhe që kanë varë veten në mjediset e paretatshme të konviktit. Parë nga largësia e të sotmes, veten time të asaj periudhe do ta përcaktoja si një personazh dikensian, edhe pse Dikensin nuk e kisha lexuar ende.

- Për të vijuar në të njëjtën linjë, në një tjetër poezi tuajën, “Në ekspozitën e piktorëve të vegjël”, shkruani:

Babai kthehet i lodhur nga puna.

Si baba, ngjan me heronjtë e filmave, të librave;

Pak me Skënderbeun, pak me Vojo Kushin,

Pak me Adem Rekën, që sapo ka mundur detin.

Ndryshe si mund të jetë një baba...

*Edhe në një intervistë keni folur për **admirimin e prindërve.***

A i takon admirimi, fëmijërisë? A ka shkuar adoleshenca juaj paralel me zbulimin e papërsosmërive prindërore? A ka shkuar rritja paralel me faljen e papërsosmërive? A është e mundur të bëni një analizë të distancuar?

- Unë e kam, sinqerisht, të pamundur të bëj një analizë të distancuar. Intervista që ju përmendni e ku unë flas për admirimin tim për prindërit është e para pak viteve. Nuk e di, në këtë intervistë apo në një tjetër, kam thënë se gjëja që më mërzi më shumë në këtë moshë, është mplakja e prindërve. Babai, që e kishte dëgjuar, ishte prekur shumë. Unë, në fakt, nuk e kam vrarë kurrë babain në kuptimin që i jep Frojdi kësaj shprehjeje. Dhe tani është tepër vonë për ta bërë një gjë të tillë: të dy prindërit janë larguar nga kjo jetë. Pra, unë e kam ruajtur deri në fund admirimin për ta. Nuk e di nëse ky fakt ka qenë benefik apo i dëmshëm për personaliteti tim, por kështu jam ndier mirë dhe, në fund të fundit, kjo ka rëndësi.

Kjo ka ndodhur, besoj unë, edhe për arsye të rrethanave. Një nga tiparet e theksuara të karakterit tim qysh në adole-

shencë, siç kam pasur rast shumë herë ta provoj, është pavarësia në marrjen e vendimeve që më përkasin. Përveç pushimeve, siç thashë, unë kam jetuar larg prindërve qysh në fund të fëmijërisë. Ata në Tropojë, unë në Tiranë. Kështu, babai, nuk ka pasur konkretisht rast të ndërhynte në vendimet e mia, gjë që me siguri do të shkaktonte një herë a një tjetër, përplasje. Sepse në traditën tropojane babai e mendon veten urdhërues të birit deri në fund, pavarësisht moshës së birit. Nga ana tjetër, edhe babai im ka qenë gjithmonë natyrë e tillë, që nuk ia ka lejuar kurrë vetes të prishë qejf me mua e as me vëllezërit e mi. Që do të thotë se, thellë-thellë, as ai nuk ka qenë një baba i vërtetë tropojan. Unë ia di për nder atij burri që nuk m’i ka shpalosur me tepri papërsosmëritë e veta. Kështu ndihem më rehat në kujtimin e gjallë që ruaj për të.

Do të shtoja edhe se kjo poezi, e shkruar kur isha 20 apo 21 vjeç, ka një lidhje zanafillore me poezinë “*Unë dhe heronjtë*”, duke u vendosur në horizontin e kundërt. Skënderbeu, Vojo Kushi, Adem Reka përfaqësojnë arketipat e heronjve, me të cilët ushqehet me idhujtari nacional-komuniste edukimi i brezit tim në fëmijëri. Babai, në kuptimin simbolik, si pjesëmarrës aktiv në fatin e atdheut, doemos që do të bëhej pjesë e kësaj idhujtarie, e cila e përjashtonte papërsosmërinë. Më duket, pra, se këto dy poezi përbëjnë dy skajet e itinerarit tim psiko-kulturor. Si të tilla, ato janë thellësisht autobiografike.

- Por, siç mund të merret me mend, nuk janë të vetmet poezi autobiografike, mes tyre është poezia “Nëna”, ku thoni:

*Binin gjethet e para të shtatorit lyer me bojë hëne.
Dëshira për lodra magjike iu zgjua befás nënës sime.
Prej ëndrrave më të largëta të vajzërisë
më thirri mua,
unë menjëherë dola,
s’mund ta lija aspak të trishtuar,
si kukull hyra në dhomën e bardhë të nusërisë.
Në fëmijërinë jetime ajo kurrë s’kish pasur kukull
në duar,
tani mund të luante me mua,
të më vishte e zhvishte sa herë të donte,
të më përkëdhelte,
përralla, që prej askujt s’i kishte dëgjuar, të më tregonte.
Për të isha lodra më e mrekullueshme për muaj e vite.*

Rregulli thotë se figura e nënës është e brishtë, krahasimisht me atë të babait. Por, sado që përjashtimi përforcon rregullin, ai ekziston. Cila ishte nëna juaj në këtë aspekt? Përballë jush, por edhe figura e saj në familje, gjithashtu.

- Ne ishim një familje tropojane krejt tradicionale. Por, në mënyrën më paradoksale, pra të papajtueshme me traditën malësore, me ne fëmijët, nëna tregohej shumë më e rreptë se babai. Jo se babai na përkëdhelte. Unë nuk mbaj mend kurrë të ketë luajtur me mua apo me vëllezërit e mi siç kam luajtur unë me qindra e qindra herë me fëmijët e mi. Ai ishte thjesht

shumë më tolerant ndaj kalamallëqeve tona nga ç' ishte nëna. Ai qortonte shumë rrallë. Ankesat e shpeshta të nënës për ne, doemos që arrinin te babai, por ai i përcillte zakonisht me një buzëqeshje, ose me heshtje, gjë që e dëshpëronte nënën. Në ndonjë rast ai e siguronte atë se ne nuk do e përsërisnim më. Madje, nuk e kam parë të mërzhitej e të nevríkosej as kur vëllezërit e mi merrnin nota mesatare apo të dobëta në shkollë. Megjithatë, ai nuk ishte aspak një burrë i lëshuar. Përkundrazi. Ishte një burrë vërtet i bukur, jo shumë i gjatë, por mbi mesatar, vishej me shumë kujdes, gjithmonë me kostum të prerë sipas masës, dimër e verë, detyrimisht i rruar çdo mëngjes, i pastër e i hekurosur, në këpucët e tij nuk shihej pika e baltës as kur kalonte nëpër rrugët me llucë të qytetit tonë, i cili, në të vërtetë, ishte ende gjysmë fshat. Ishte ndër më të shkolluarit e moshës së tij në krahinë dhe pas ushtrisë kishte punuar vetëm në zyrë. Siç kam shkruar më lart, ai kishte qenë në fillim shef llogarie në një ndërmarrje e pastaj, për afro njëzet vjet, drejtor i bankës, ku edhe doli në pension të parakohshëm në vitin 1992. Ishte një burrë shumë i respektuar në mjedisin shoqëror të qytetit tonë dhe mbeti i tillë deri në fund.

Nëna ime ishte, në njëfarë mënyre, krejt e kundërta. Ajo nuk ka pasur kurrë ndonjë bukuri femërore të spikatur. Vishej thjesht, me tesha qyteti, kuptohet, por që i blinte zakonisht të gatshme. Nga tradita ruante vetëm shaminë e bardhë në kokë, që nuk e hoqi as në rini e as në pleqëri. Kur janë martuar prindërit e mi, ajo ishte analfabete. Në fshatin e saj të lindjes nuk kishte pasur kurrë shkollë. Shkrim e këndim ajo ka mësuar shumë vonë, në shkollë nate, kur edhe unë

shkoja tashmë në shkollë. Uleshim bashkë pasditeve për të bërë detyrat. Ajo punonte pastruese në hotelin e qytetit.

Babai im e ka trajtuar gjithmonë me respektin më të madh, duke ia njohur faktin se ajo ishte një zonjë e mrekullueshme shtëpie dhe ia dha asaj qysh në fillim vendin qendror në familje. Kjo edhe për arsye të respektit dhe dashurisë atërore që ushqente gjyshi im për nënën time. Por nuk besoj se ata të dy kishin një komunikim bisedimor shumë intim, gjë që ishte brenda traditës së një çifti malësor, pavarësisht se babai im në publik ishte ai që jua përshkrova më sipër.

Poezia që ju përmendët pasqyron një dëshirë të përhershme dhe të papërbushur, që ajo kishte për të folur për veten, dhe gjurmën e mirë që ka lënë në imagjinatën time kjo dëshirë e saj. Ndoshta sepse isha i pari ndër fëmijët e saj, ndoshta sepse isha dëgjues më i mirë se vëllezërit e mi, nuk e di, por ajo më kishte zgjedhur mua për të më rrëfyer jetën e vet. Veçanërisht nuk lodhej së treguari për fëmijërinë e saj jetime. E mbetur pa nënë qysh foshnjë, pak më vonë edhe pa baba, e kishin rritur si kishin mundur, por me dashurinë e zemrës, dy vëllezërit më të mëdhenj, të cilët ishin për veten e tyre fëmijë. Nuk e mbaj mend t'i jepte ndonjë rëndësi në këto tregime varfërisë apo vështirësive të tjera materiale. Vetëm mungesa e dashurisë prindërore e kishte shënjuar me hekur të skuqur. Kjo filloi të më bënte pak e nga pak përshtypjen më të madhe tek e dëgjoja kur edhe po rritesha dhe e kuptoja më mirë çfarë më thoshte.

- Më vjen instiktive që, teksa ju pyes për jetën tuaj, t'u referohem poezive tuaja, ndoshta ngase besoj se poezia është autobiografi. Ndaj, sërish te poezitë do të vijoj të rri: **Borxhi ndaj nënës dhe Borxhi ndaj babait**, janë dy poezi tuajat kushtuar secilit prej prindërve. Janë të ndryshme poezitë sepse janë të ndryshme borxhet që duhet të shlyenit Babait i takon pjesa e tij në **gëzimet dhe dështimet** tuaja, kurse **rrugën, në të cilën ka vënë këmbën fëmija, e ka provuar më parë nëna nëse mban** Si do t'i përshkruanit dallimet mes **borxheve** ndaj secilit?

- Këto dy poezi janë të hershme. Janë shkruar para se unë t'i mbushja 25 vjet, por kur kisha dalë në jetën time të pavarur, sidoqoftë. Të dyja përshkohen dukshëm nga adhurimi im për prindërit, adhurim për të cilin folëm edhe më lart. Me një artific për t'i parë si krijime të dikujt tjetër, do të thosha se këto dy poezi plotësojnë njëra-tjetrën dhe nxjerrin qartë në pah mentalitetin e autorit si një djalosh malësor thellësisht tradicional përkitazi me figurën e babait dhe të nënës. Nëpër vargje jepet informacion i mjaftueshëm, më duket mua, për të kuptuar se fizikisht njeriu-poet ka dalë tashmë jashtë qarkut rrezatues të prindërve të vet, madje edhe në gjeografi jeton larg tyre. Por funksionalisht vazhdon të ndihet brenda këtij rrezatimi në një mënyrë të pashpresë për ndryshim, sepse lidhja nuk është më nëpërmjet kërthizës, është mitologjike.

Parë në mentalitetin tradicional të malësorit të Tropojës, *babai doemos që është shtylla, mishërimi i mendjes, i ambicies, i guximit. Ndërsa nëna mbetet mishërimi i zemrës.* Në këtë perspektivë antifrojdiane e shpalos veten poeti. Do

thënë se shprehja e ndjenjave të respektit dhe të mirënjohjes së pakushtëzuar për prindërit ka qenë mjaft e përhapur në poezinë shqipe të realizmit socialist. Deri edhe korifentjtë e kësaj poezie, Arapi, Agolli, Kadare kanë shkruar të tilla. Nëse këto dy poezi sjellin sadopak diçka të re në antologjinë e gjerë të poezisë shqipe të asaj periudhe me këtë temë, kjo do kërkuar në trajtimin mitologjik, që i bëhet në këtë rast kësaj lidhjeje të pakëputur ombelikale, duke nxjerrë në pah me një sintaksë të qartë e të ftohtë të pashpjegueshmen, enigmatiken që vazhdon ta mbajë poetin varur pas atësisë dhe amësisë së vet. Një sinoptikë e tillë mitologjike e përjashton si trup të huaj emocionin ditirambik, domethënë shpesh veselitës, që mbisundonte në poezinë e bollshme të realizmit socialist kushtuar prindërve. Kjo, të paktën, ka qenë qasja ime estetike.

- Figura qendrore e familjes suaj ishte gjyshi. E thatë më lart. Fundja, i zoti i shtëpisë ishte ai. Nga ana tjetër, ju kishit njëfarësoj dy gjyshe. Nëna e babait tuaj dhe gruaja e parë e gjyshit tuaj. Të dyja gratë jetonin në një shtëpi. Më duket interesante të dimë si ishte e ndërtuar hierarkia në familjen tuaj. Si funksiononte familja? Cili ishte modeli, sa ngjante me modelet e kohës dhe të vendit? Si e shihte fëmija i 50 viteve më parë e si e shihni sot mënyrën e funksionimit të familjes në të cilën jeni rritur?

- Sigurisht që në Tropojë, para gjysmë shekulli, rasti i bashkëjetesës së gjyshit tim me dy gra nën një çati, nuk ishte i vetmi. Por ky nuk ishte kurrsesi as modeli i familjes tropojane

që vinte nga e kaluara parakomuniste, siç ishin gjyshërit e mi dhe aq më pak ishte modeli i familjes socialiste, siç i qëllonte kalendarikisht, të ishin prindërit e mi. Nga pikëpamja e sotme, brenda shtëpisë sime stërgjyshore, i bie të jetonin, në fakt, dy familje, njëra nga të cilat, ajo e gjyshit, ishte atipike. Pyetja juaj lidhur me hierarkinë brenda një bashkësie të tillë është interesante.

Familja tradicionale tropojane ka qenë zakonisht e madhe. Ajo përfshinte dy breza të martuar. Ndonjëherë, kur plaku jetonte gjatë, edhe tre breza. Vëllezërit jetonin, të gjithë, bashkë me babain. Pra, kishte shumë meshkuj në moshë të madhe. Rrjedhimisht, nevojitej një autoritet i vërtetë për të ndarë punët dhe përgjegjësitë, për të administruar buxhetin dhe për të përfaqësuar familjen në kuvendet e burrave. Në përgjithësi, këtë autoritet e mishëronte plaku i shtëpisë, babai. Në rrethanat historike dhe politike të periudhës së fëmijërisë time, një autoritet i tillë ishte praktikisht i panevojshëm.

Duke qëndruar te shembulli i familjes sime, i zoti i shtëpisë nuk kishte më ndarje të punëve të ditës për të bërë, as ndonjë buxhet të vërtetë për të administruar dhe as rast për ta përfaqësuar familjen në ndonjë kuvend burrash. Edhe familja jonë, si të gjitha familjet e kamura, ishte shpronësuar. Kuvendet e burrave ishin zëvendësuar me mbledhjet edukative të lagjes. Megjithatë, autoriteti moral mbetej gjyshi, ani pse ai nuk bënte asgjë pa u këshilluar me babain tim, që do të thotë se *de facto* ishte fjala e babait tim që peshonte. Gjatë gjithë fëmijërisë dhe adoleshencës sime, sa ai ishte gjallë, e kam parë vetëm një herë gjyshin të impononte zgjedhjen e vet. Qyteti ynë po zgjerohej. Prisheshin shtëpitë e vjetra,

kulla me mure të trasha guri dhe bahçet e mrekullueshme dhe në vend të tyre ngriheshin ca pallate të shëmtuara katër e pesëkatëshe, ku strehoheshin nëpër apartamente të ngushta familjet e ardhura nga fshatrat, por edhe ne, vendasit. Kur i erdhi radha shtëpisë sonë, gjyshi i kërkoi babait të përdorte gjithë ndikimin e tij që ajo të mbetej në këmbë. Ai donte të mbyllte sytë aty ku kishin ndërruar jetë të parët e tij. Dhe ashtu ndodhi. U shkulën mollët, kumbullat, dardhat, ftonjtë, hardhitë, manat, arrat, fiqtë e bahçes sonë, u rrafshua me traktor oborri, por shtëpia nuk u prek. Nga i gjithë fshati Kolgecaj, mbi të cilin është ngritur qyteti i Bajram Currit, sot ka mbijetuar si relikte vetëm shtëpia jonë, e rrethuar nga ato pallatet bajate. I jam mirënjohës gjyshit për vendosmërinë. Përndryshe, mendoj se babai do të kishte ndjekur berihanë e kohës dhe fëmijët e mi nuk do e kishin parë kurrë shtëpinë ku kam lindur unë.

Më delikatja brenda kësaj familjeje ishte ruajtja e harmonisë, më mirë le të themi, e ekuilibrave, pikërisht për shkak të bashkëjetesës në të njëjtën shtëpi të dy grave të gjyshit tim. Kur jam bërë unë për t'i kuptuar gjërat, gjyshi nuk flinte më me asnjërin. Ky realitet me shemra nuk kishte asnjë lidhje me të drejtën e myslimanit, që kishte gjyshi im, për të pasur disa gra njëkohësisht. Dada Shkurtë, siç e thërrisnim ne fëmijët njerken e babait tim, kishte qenë e re kur e kishte kuptuar se nuk bënte dot fëmijë dhe e kishte nxitur gjyshin tim të martohej sërish. Por i ishte lutur t'i linte një copë vend për të jetuar në pronat e familjes, që ishin të bollshme. Nuk donte të kthehej tek të vëllezërit, në fshatin Valbonë, siç ishte zakoni. Tani që e shoh nga larg, do të

thosha se jeta e familjes sonë ishte një lloj teatri, regjinë e të cilit e bënte në të vërtetë babai im, i cili egon e nënës së vet nuk e gjente si arsye të mjaftueshme për të lejuar prishjen e paqes brenda familjes dhe kishte autoritetin që, pa përplasur grushtin mbi tryezë, të frenonte teprimet e s'ëmës dhe njëherësh të çlironte nga kompleksët e inferioritetit njerikën, duke i krijuar edhe asaj një ndjesi barazie në shtëpi. Me ne të tjerët e kishte të lehtë.

- Njëerën nga gjyshet, atë të vërtetën, ju e përshkruani kështu në një poezi:

*Dikur pashë gjyshen të endej symbyllas nëpër oborr
Duke nëmur veten pa asnjë shkak,
Dëgjova gjyshin t'i thërriste prej brenda e të nëmte
Vetëm pse ajo mbante tërë kohën nëmën në gojë...*

Si ju vijjnë dy gjyshet në kujtesë?

- Gjyshja ime i kishte të gjitha atributet për t'u ndier blea mbretëreshë në atë koshere: ishte një grua shumë e bukur, të paktën 20 vjet më e re se i shoqi dhe nëna e trashëgimtarit të vetëm të emrit të familjes. Ajo kishte vetëdijen e një gruaje shumë të bukur, të cilës i takon ta zërë e vetme qendrën e vëmendjes së atyre që e rrethojnë. Dhe hante veten me dhëmbë kur shihte se kjo qendër ndahej me shemrën e saj jo vetëm nga i shoqi, por edhe nga i biri. Rrjedhimisht edhe nga ne, nipërit. Dada Shkurtë ishte edhe fizikisht, edhe në

sjellje e kundërta e gjyshes sime. Ajo ishte shumë diskrete, por buronte dashuri pa kushte për ne.

Nana Lake (gjyshja e vërtetë), siç ma merr mendja mua tani, do të kishte dashur shumë që të zbatohet parimi “O me mua, o kundër meje”. Por nuk gjente terrenin e përshtatshëm, nuk gjente aleatë. E vetme ajo e dinte se nuk e fitonte luftën. Nana Lake ishte nga Vuthajt, një fshat shqiptar i mbetur në Mal të Zi pas ndarjes së kufijve. Ajo kishte një vetëndierje të madhe për përparësitë e veta. Si e tillë, ajo i ushqente vetes një bindje të fshehtë se i shkonte pak ilitim, vetëndierje, që nuk e humbi as në pleqëri. Por ajo ishte e edukuar mirë me normat e zakonit të maleve dhe nuk do t’ia lejonte kurrë vetes t’i shkelte këto norma. Gruas malësore, pushtetin në familje ia jep djali kur rritet dhe vihet *de facto* në krye të punëve. Babai im, edhe pse e donte shumë, nuk ia dha këtë pushtet për arsye që i shpjegova më lart. Ai e kishte kuptuar se kjo do të prishte ekuilibrat në familje, gjë që do të çonte pashmangshëm në sakrifikimin e Dadës Shkurtë, për të cilën ai vetë ndiente një dhimbsuni të thellë, të sinqertë. Nana Lake, kur mbushej sa nuk mbante dot më, dilte në oborr, gjithmonë kur babai nuk ishte në shtëpi, dhe shfrynte me vete, por me zë, ashtu siç e kam përshkruar në poezinë që përmendët. Shfrynte me zë, sepse donte, gjithsesi, që ne ta merrnim vesh çfarë i ziente në shpirt, por pa na vënë në detyrimin as ta miratonim, as ta kundërshtonim e as ta ngushëllonim.

Dada Shkurtë, nga ana e vet, nuk i jepte kurrë shkas për përplasje. Fakt është se unë nuk i kam parë kurrë ato të dyja të shkëmbejnë as replikën më të vogël me njëra-tjetrën. Dhe kur vdiq Dada Shkurtë, në vitin 1971, Nana Lake kishte një shprehje të sinqertë pikëllimi në fytyrë. Mua, që po më rridhnin

lotët në çastin kur e nxorën arkivolin nga shtëpia, më mori për qafe e më tha: “*Qaj, djali jem, qaj! Të ka dashur shumë*”.

- *Gjyshi ju merrte me vete... (në një poezi flisni për mësimet e dhëna nga gjyshi). Ç'bën një fëmijë mes burrash? Si ndihet në një shoqëri të tillë? Si ishin figurat e burrave të qytetit tuaj, imazhet, bisedat që bënin... Cilat ishin mësimet që merrnit mes tyre?*

- Po, gjyshi ka filluar të më marrë pas vetes qysh kur isha fare i vogël. Unë nuk kam qenë fëmijë i dhënë pas lojës, si moshatarët e mi. Kjo e rriste gatishmërinë time për ta ndjekur. Pleqtë e brezit të tij nuk ishin burra kafenesh. Ata takoheshin kryesisht nëpër shtëpitë e njëri-tjetrit, ku, sigurisht, pinin shumë kafe. Në Tropojë, burrat e atij brezi, të mbledhur për t'u parë, pa ndonjë arsye të posaçme, nuk pinin as raki e as çaj. Vetëm kafe. Njëra pas tjetrës. Ai më merrte me vete, madje, edhe nëpër sebepe të rëndësishme së veçantë, siç ishin dasmat apo përcjelljet mortore, nëpër oda ku mbledheshin shumë burra të moshuar e më pak të moshuar. Më ulte gjithmonë pranë vetes e më porosiste: dëgjo! Pra, unë aty nuk kisha të drejtë fjale. Besoj se në atë periudhë është kalitur tek unë, ngadalë, aftësia për t'i dëgjuar me vëmendje të tjerët dhe bindja se gjithkush ka diçka interesante për të thënë.

Bisedat e pleqve malësorë kanë pasur gjithmonë një lartësi të caktuar. Në to përjashtojë vulgariteti, përgojimet, fyerjet. Në këto biseda tregoheshin shumë histori, të jetuara e sidomos të dëgjuara brez pas brezi nga të pranishmit. Këto

biseda ishin si parabola, nëpërmjet të cilave burrat ia thoshin njëri-tjetrit me nënkuptime mendimet e veta. Kjo ishte, për mua, si shkolla e Sokratit. E kam të vështirë ta përmbledh me pak fjalë se çfarë kam mësuar në këtë shkollë, por e them me siguri se nuk mërzhitesha kurrë, gjë e panatyrshme për një fëmijë, edhe pse më ka qëlluar të qëndroj ulur në mjedise të tilla me orë të tëra.

*- Po i quaj lojërat e fëmijërisë, por ndoshta do të ishte më e saktë të thuhej **angazhimet fëmijore**. Këtu dua të rrimë: libra, letra, lapsa dhe tubete akuareli, një trombon, me siguri edhe topi i futbollit janë disa nga objektet që e përcaktojnë fëmijërinë tuaj. Cilat ishin prioritetet? Si i vinit në ekuilibër? Si e përcaktuan të ardhmen tuaj?*

- Asgjë sportive nuk bën pjesë tek argëtimet e mia të fëmijërisë. Isha sedentar. “Si plak”, më shfrynte nëna ime, e cila nuk pajtohej me këtë natyrë të panatyrshme jetese për një fëmijë, që kisha unë. Përveç leximit, pas të cilit isha dhënë me babëzi qysh sa mësova germat, kur isha në klasë të pestë, në botën time hynë edhe dy pasione të reja: vizatimi dhe muzika. Por jo muzika në kuptimin që kishte edukimi muzikor për shumë fëmijë të moshës sime në Tiranë apo në Shkodër.

Në maj 1970, në Tropojë erdhi për vizitë Enver Hoxha. Ai u prit me hare të madhe popullore, siç merret lehtë me mend nga ata që e kanë jetuar atë kohë. Por organizatorët e festës, të cilët e shoqëronin udhëheqësin e madh, vunë re një mungesë: qyteti nuk kishte fanfarë. Fill pas u mor vendimi

që pranë shtëpisë së kulturës të qytetit të ngrihej fanfara. U dërguan pa vonesë instrumentet dhe një instruktor i huazuar nga banda e ushtrisë. Në Tropojë gjeje plot burra që i binin çiftelisë, lahutës apo fyellit, madje edhe në mënyrë virtuoze, por instrumentet e tunxhit ishin krejt të panjohur për malësorët. Për më keq, nuk gjendeshin as aspirantë për t'i mësuar. Fanfara do t'i bënte shfaqjet e saj nëpër rrugët e qytetit në ditët e festave po e po, por shpesh edhe të dielave të zakonshme, për të krijuar atmosferë të gëzueshme, siç do të na thuhej ne, që do ta krijonim. Burrave tropojanë u vinte turp të parakalonin nëpër rrugët e qytetit me ato instrumente të mëdha tunxhi varur në qafë, duke luajtur në ecje një muzikë të cilën ata në të vërtetë as e kuptonin e as e shijonin. Sipas përfytyrimit të tyre, ata do të bëheshin pjesë e një pamjeje groteske. Përfundimisht, instruktori i ardhur nga Tirana për të ngritur fanfarën, u drejtua në shkollë të gjente muzikantët që i duheshin. Mua më zgjodhi vetëm për buzët e trasha që kisha. E mbushin mirë bukinën e trombonit, më tha duke më caktuar menjëherë edhe instrumentin. Nuk më bëri asnjë provë në kisha sadopak vesh muzike.

Unë, pra, jam trombonisti i parë në Tropojë. I jam edhe sot e kësaj dite mirënjohës atij burri që ma dha këtë mundësi. Tromboni është një instrument ritmi. Partiturat e tij shkruhen në çelësin e sisë, një shkrim muzikor ky që do e zbulojë me atë rast. Në shkollë më kishin mësuar vetëm pentagramin që fillon me çelësin e solit. Pa e ditur ç'po më ndodhte, unë mora kështu njëfarë edukimi muzikor, që nuk do ta kisha marrë kurrë në rrethanat e mia të zakonshme. Këtu e ka zanafillën pëlqimi i madh që kam unë prej vitesh

për muzikën xhaz. Dhe jo vetëm kaq: ne paguheshim. Gjatë gjithë shkollës tetëvjeçare, unë merrja një mijë e dy qind lekë në muaj, që ishte më shumë se një e treta e pagës së nënës sime. Ky detaj nuk ishte pa rëndësi për buxhetin e familjes.

- ***“Të gjithë fëmijët, - thoshte Pikaso, - janë artistë të lindur. Çështja është të mbeten të tillë kur të rriten.”*** Ju referova Pikasos duke pasur parasysh ëndrrat me pikturë të fëmijërisë suaj. Pra, fëmijë ishit piktor, por nuk mbetët kur u rritët. Një dorëheqje, në fakt, e imponuar, por që nuk e kundërshtuat aspak. Ngriti krye racionalizmi brenda jush dhe gjetët paqe? Apo me besim te babai, që kishte një tjetër ide për të ardhmen tuaj, thjesht u bindët?

- Në po këtë periudhë, pra kur isha në klasën e pestë, në shkollën tonë erdhi nga Tirana një mësues i ri vizatimi, Buron Kaceli, i cili sapo kishte mbaruar Institutin e Lartë të Arteve. Ai vuri re se unë kisha dorë të mirë dhe më nxiti të vizatoja. Buroni kishte një dhomë të vogël brenda në shkollë, ku flinte dhe pikturonte. Unë shkoja pasditeve në dhomën e tij dhe ai më fliste për pikturën, për piktorët dhe më mësonte të vizatoja. Ai zgjoi kështu ëndrrën time për t’u bërë piktor, gjë që nuk kishte ndodhur me muzikën. Unë nuk ëndërroja të bëhesha muzikant, edhe pse ushtrohesh çdo ditë me gjithë zellin në trombon. Te prindërit e mi kjo ëndërr nuk ngjalli as gëzim, as kundërshtim. Mund të them, madje, se babai im e mbështeste për aq sa i takonte. Sa herë vinte në Tiranë për punët e veta, ai blinte për mua letër të mirë

për vizatim, lapsa, pastele, penela, akuarele dhe, kur isha në klasën e tetë, edhe bojëra vaji, materiale këto që, sigurisht, nuk gjendeshin në Tropojë, sepse nuk i hynin njeriu në punë, përveç meje. Buron Kaceli u kthye në Tiranë pas një viti, por unë vazhdova të ushtrohesh në vizatim, me mbështetjen e një mësueseje të re, Sanies, e cila sapo kishte përfunduar Liceun Artistik dhe mua më ndihmonte gjithë dashuri me besimin në talentin tim.

Sipas parashikimit tim dhe me miratimin e plotë të babait, në përfundim të klasës së tetë unë erdha në Tiranë për të kaluar konkursin në Liceun Artistik. Babai më shoqëroi. Unë vija për herë të parë në kryeqytet. Përgjigjja mbërriti në gusht dhe unë kisha fituar. Aty babai ndryshoi menjëherë. Më mori mënjane dhe, me atë qetësinë e tij të zakonshme, më tregoi çfarë e ardhmeje më priste si piktor në Tropojë. Në krahinë tonë nuk kishte ende asnjë vendas që të kishte mbaruar Institutin e Lartë të Arteve. Por në Bajram Curri ishte një kapanon që quhej “Reparti i pikturës”. Aty bëhej dekori politik i qytetit, që do të thotë se shkruheshin parullat në beze, zmadhoheshin portretet e Enverit dhe të udhëheqësve të tjerë, stampoheshin pllakatet revolucionare. Aty punonin tri-katër veta dhe përgjegjës kishin një burrë të këndshëm, që e kishte mësuar këtë zana në ushtri dhe që shihej gjithë kohën me pantallona e me këmbë të llangosura me bojëra. Ai njihej nëpër qytet si “piktori”. Ti vendos vetë si të duash, më tha babai, por si ai do të bëhesh. Mua sikur më vuri përpara një pasqyre dhe nuk më pëlqeu fare vetja burrë. Hoqa dorë me aq nga ëndrra ime për t’u bërë piktor.

- *Librat e fëmijërisë nuk mund t'i shpërfillim, sidomos në rastin tuaj. Shumëkush, kur flitet për leximet e fëmijërisë, përmend tituj, sikurse “Liza në botën e çudirave”, “Tom Sojeri”, “Pinoku”... apo përralla, shumë përralla. Kurse ju, siç kam lexuar në një intervistë, keni thënë se leximet e hershme lidhen me bibliotekën e babait, e për rrjedhojë me libra të rriturish. Madje keni përmendur tituj, sikurse “Lufta dhe Paqja”, “E kuqja dhe e zeza”, pra klasikët e mëdhenj të letërsisë botërore të shekullit të XIX... Si i perceptonit ato lexime? Si ndiheshit në botët nëpër të cilat ju fusnin? Sa përplaseshin me botën e fëmijës në të cilën ndodheshit?*

- Me aq sa kam parë gjatë fëmijërisë nëpër shtëpitë e moshatarëve të mi, babai im kishte, pa dyshim, bibliotekën më të pasur. Shoku më i ngushtë i babait tim, Mal Braha, ishte librari i qytetit. Ai ishte një personazh i jashtëzakonshëm. Ishte pak më i ri se babai im, por vdiq shumë më herët. Mal Braha kishte studiuar dy vjet në Pragë. Me prishjen e marrëdhënieve me kampin socialist, më 1961-1962, ishte kthyer si të gjithë studentët e tjerë. Në këtë kohë zbuloi edhe se ishte prekur nga tuberkulozi. Ai nuk kishte pranuar të vazhdonte studimet në Universitetin e Tiranës, duke nxjerrë përpara sëmundjen. Unë gjithmonë kam menduar se ky ishte një pretekst. Ishte një burrë i imët, flokëverdhë, shumë simpatik, me një pamje të rafinuar, që nuk ngjante fare me burrat e qytetit tonë. Ishte krejt i vetmuar, pa grua, pa fëmijë, me vetëm dy a tre shokë, i heshtur, pinte shumë duhan, pinte edhe konjak shumë, në të gjitha orët e ditës që i jepej rasti, por nuk dukej kurrë i dehur. Besoj se kapërcimi nga Tropoja në Pragë dhe ato dy vjetët që kishte

jetuar atje kishin lënë një goditje të pandreqshme në psikikën e tij. Ndërprerja brutale e studimeve, domethënë ndërprerja brutale e jetës atje, i kishin shkaktuar mirëfilli humbjen e shijes për jetën. Ai nuk fliste kurrë për atë periudhë, madje as kur kishte pirë me tepri. Kishte zgjedhur të kthehej në vendlindje, siç do të kishte zgjedhur të mbyllej në një manastir. Dhe kishte mundur të merrte punën më të përshtatshme për të, shitës në librarinë e vetme të qytetit tonë. Ai mbante gjithmonë për babain tim një kopje të librave më të mirë që vinin, zakonisht letërsinë e huaj klasike. Shumë rrallë ndonjë autor shqiptar, të llojit të Mitrush Kutelit apo të Petro Markos. Më pas edhe prozat e Kadaresë e të Agollit.

Ne kishim kështu në shtëpi një bibliotekë të mirë dhe që pasurohej pareshtur. Babai sillte në shtëpi edhe botimet e Enver Hoxhës, që e kishte të detyrueshme t'i blinte si kuadër që ishte. Por nuk e kam parë kurrën e kurrës t'i shfletonte. Ato i lexonte me një zell të çuditshëm gjyshi im. Kam shkruar një ese për këtë, që është botuar te *"Bishti i Kometës"*.

Babai im lexonte romane. Ky ishte i vetmi argëtim i tij në kohën e paktë që nuk ishte në zyrë. Por ne nuk kishim në shtëpi libra për fëmijë. Babai nuk sillte të tillë, edhe pasi vuri re që unë fillova të lexoj romanet e tij. Ka pasur një shpërfillje të pabesueshme ai ndaj leximeve të mia. As nuk më këshillonte, as nuk më nxiste, as nuk më ndalonte. Por, kur i kërkoja pará për të blerë një libër, m'i jepte gjithmonë pa qenë nevoja t'i lutesha. Më përjashtim të *"Pinokut"*, një botim shumë i vjetër, i përkthyer në gegnisht, që nuk e di si kishte përfunduar në bibliotekën tonë, leximet e mia qysh para moshës 10-vjeçare ishin: Tolstoi, Hygo, Balzak,

Stendal, Dostojevski, Gorki, Gollsuorth, Shollohovi, Mitrush Kuteli, Petro Marko, Kadare, Jakov Xoxa, Agolli. Romane. Vetëm romane. Kur fillova të blej libra vetë, nuk e kisha më shijen e librave për të vegjël. Kam sot në bibliotekën time libra që i kam blerë vetë kur isha në klasën e tretë apo të katërt, si “*Shkëlqimi dhe rënia e kurtizaneve*”, “*Lusien Leveni*”, “*Një tragjedi amerikane*” apo “*Hasta la vista*”. Unë nuk e di si përplaseshin ato lexime me botën time fëmijore. Nuk më kujtohet. Por di që subjektet e tyre i mbaj mend sot e kësaj dite dhe, madje, shumë më mirë nga ç’mbaj mend subjektin e një romani të mirë, që kam lexuar vitin e kaluar. Më së paku kjo do të thotë se historitë e treguara në këto romane më kanë pëlqyer qysh atëherë.

- *Po përrallat, legjendat e zonës, të dëgjua nga gjyshër ose jo?*

- Përralla shumë pak. Me përjashtim të nënës, e cila na tregonte mua dhe vëllezërve të mi përralla aq sa dinte, por nuk dinte shumë, zakonisht për të na vënë në gjumë kur ishim fare të vegjël, të tjerët në shtëpinë tonë, jo. Legjenda po, shumë. Ato i dëgjoja kryesisht nëpër bisedat e pleqve, kur isha me gjyshin. *Ata i tregonin legjendat me të njëjtën siguri siç tregonin edhe historitë, i përzienin legjendat me historitë me një natyrshmëri dhe besim të pakundërshtueshëm tek e vërteta e tyre ku humbiste kufiri midis realitetit historik dhe realitetit të përfytyruar. Do të kisha thënë se ata burra, gjithçka e tregonin me*

ndershmërinë që pritet ta kenë vetëm dëshmitarët e betuar për të thënë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën. Muji e Halili, Hasan Prishtina e Bajram Curri, Gjergj Elez Alia dhe Isa Boletini, Ago Ymeri dhe Abdyl Frashëri apo Ismail Qemali, zanat dhe turqit, kuçedrat dhe serbët përmendeshin në të njëjtën fjali si protagonistë të të njëjtës histori. Dy nga romanet e mi, “*Gjinkallat e vapës*” dhe “*Një sagë e vogël*”, janë të ushqyera drejtpërdrejt nga këto legjenda. Dhe, madje, stili im, gjatë rishkrimit të tyre si narracion romanesk, është i ndikuar shumë nga stili rrëfyese i tregimtarëve, prej të cilëve i kam dëgjuar.

- *Le t’i rikthehemi edhe pak fillimit të bisedës, por në një këndvështrim tjetër. E kam fjalën për dëshirat e fëmijës. Keni thënë në një intervistë: “... gjëja që e kujtoj vërtet me mall nga fëmijëria, është aftësia që kisha në atë moshë për të ushqyer brenda vetes dëshira të parezalizueshme. Kjo e ka zhvilluar shumë imagjinatën time. Me kohë e kam humbur këtë aftësi dhe më vjen keq”. Ka humbur fëmija brenda jush? Nëse jo krejtësisht humbur, ç’keni ruajtur ende? Ç’e zbeh fëmijën brenda burrit?*

- Kjo është një pyetje shumë e ndërlikuar për mua. Për t’i dhënë një përgjigje të sinqertë do të më duhej të kryeja një introspeksion të madh te vetja, që nuk jam i gatshëm ta bëj. Më pëlqen të besoj *a priori* se fëmija brenda meje nuk ka humbur plotësisht. Herë pas here më qëllon t’i jap vetes ndonjë provë që ma përforcon këtë besim. Për shembull, unë vazhdoj t’i marr vendimet e vështira me shpejtësi dhe pa u